



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assembly

SHPLLJE E REKRUTIMIT

Komuna e Kaçanikut, në mbështetje të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregullores Nr.02/2010 për procedurat e rekrutimit në shërbimin civil, me qëllim të zbatimit të projektit me DEMOS-in "Evidentimi i pronave komunale", më datë 01.06.2016 shpallë konkursin me angazhim afatshkurtër për plotësimin e vendeve të punës :

I. GJEODET(në cilësi të evidentuesve) -3 pozita

II. JURIST (në cilësi të evidentuesëve)- 3 pozita

Drejtoria: Drejtoria e urbanizmit, kadastrit dhe mbrojtjes së mjedisit

Paga mujore- 300.00€

Numri i referencës së vendit të punës: 06Nr.111-18383/16

Përshkrimi i detyrave të gjeodetit /juristit në cilësinë e evidentuesit

Secili nga evidentuesit/gjeodetit dhe juristët e përzgjedhur do ta ndjekë në tërësi trajnimin mbi evidentimin e pronave komunale, si dhe udhëzimet përcjellëse në lidhje me punën në teren. Në bazë të udhëzimeve të zyrës për pronë dhe drejtorisë së financave, kandidatët e përzgjedhur duhet të realizojnë regjistrimin e pronave të paluajtshme në qytet, lagje, dhe fshatra përkatëse, sipas planit të veprimit të përcaktuar nga komuna dhe projekti DEMOS. Poashtu kërkohet të bëhet raportimi i rregullt tek zyrtarët komunalë dhe përfaqësuesi i projektit DEMOS, mbi zhvillimet në terren dhe mbi rezultatet e arritura gjatë punës në teren. E gjithë puna e sipërpërmendur duhet të përfundojë deri më 30 Tetor, 2016, përfshirë këtu edhe trajnimin 1 mujor.

Procedura e konkurimit: është e hapur për të gjithë kandidatët e jashtëm .

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim:

Përveç kushteve të përgjithshme kandidatët duhet të plotësojnë edhe kushtet e veçanta,

Shkollimi i kërkuar :

Për pozitën e gjeodetit kërkohet :

- Të kenë të perfunduar Fakultetin e Gjeodezisë, ose të jetë së paku student i vitit të fundit

Për pozitën e juristit kërkohet:

- Të kenë të perfunduar Fakultetin Juridik, ose të jetë së paku student i vitit të fundit

Aftësitë, përvoja dhe attribute tjera që kërkohen:

- Përparsi kanë kandidatët me përvojë në evidentim të pronave ose në kadastrë
- Përparësi kanë kandidatët që kanë bërë punë terreni në të kaluarën
- Përvojë në angazhim me institucionet shtetërore
- Përparësi kanë kandidatët që zotojnë gjuhën Serbe
- Te kete aftesi komunikative, i qarte, konciz dhe bashkëpunues me qytetarë.
- Të ketë aftësi kompjuterike të paketës së Microsoftit s: Excel, Word dhe Access.

Lloji i kontratës: " Marrëveshje për shërbime të veçanta"

Kohëzgjatja e emërimit : Tre (3) muaj ose 66 ditë pune

Data e mbylljes së konkursit; Konkursi mbetet i hapur 8 ditë nga data e shpalljes në mjetet e informimit publik, prej 01.06.2016 deri më 08.06.2016.

Formularët e aplikimit merren dhe dorëzohen në Qendrën për shërbim me qytetar -Zyra e pranimit, kati përdhës dhe në web-faqen komunale . Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten këto dokumente: biografinë e tyre (CV) së bashku me kopjen e vërtetuar të diplomës së shkollimit, vërtetimin e përvojës së punës, certifikata mbi trajnimet e kryera ,kopjen e letërnjoftimit, certifikatën-ekstraktin e lindjes, dëshminë se nuk është në hetime dhe se paku një rekomandim/reference nëse posedon.

"Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë" .

"Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në nenin 11, paragrafin 3 të Ligjit Nr.03/L-149 për shërbimin civil të republikës së Kosovës. Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara mund të refuzohen.

Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuara, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listen e ngushtë do të kontaktohen. Për çdo informacion kandidatët mund të kontaktojnë zyrën e personelit.

Kryetari i Komunës
Besim Ilazi